



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.7.2023

Nr: 708

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**LIRIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARIT TË KZAZ NR. 43, BASHKIA RROGOZHINË, PËR
PËRSËRITJEN E ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 23 KORRIK 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, është kërkuar zëvendësim i anëtarit të KZAZ-së si më poshtë:

Partia e Lirisë, në bazë të kërkesës së tyre, datë 19.07.2023, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 43, Bashkia Rrogozhinë.

Propozimi dhe kandidatura e paraqitur plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ-së nr. 43, zj. Behare Pëllumb Kasa, Bashkia Rrogozhinë.
2. Emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 43, z. Hekuran Selman Xhani, Bashkia Rrogozhinë.

Data: 20.7.2023 Nr: 708
Ora: 10:00



“Për lirimin dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 43, Bashkia Rrogozhinë, për përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar bashkie të datës 23 Korrik 2023”

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

